



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 4, datë 31.01.2018

**PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË Z. EDLIR RUKA SI DREJTOR EKZEKUTIV I
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ANSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 25, pika 3 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, dhe nenit 4 të Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrjes, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimi”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e riemërimit të z. Edlir Ruka si Drejtor Ekzekutiv i shoqërisë së sigurimit “Ansig” sh.a., për një afat 3 (tre) vjeçar, nga data 15.01.2018, deri në 14.01.2021.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI